LIGJ
Nr. 182/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 19, "Furnizime të përjashtuara", pika 1, pas numrit "25.10" shtohet numri "25.11".

Neni 2

Në nenin 25/1, "Operacionet hidrokarbure", fjalët "lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure" zëvendësohen me fjalët "lidhur me realizimin e fazës së kërkimit".

Pas shkronjës "a" shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit.".

Neni 3

Pas nenit 25/10 shtohet neni 25/11 me këtë përmbajtje:

"Neni 25/11
Barnat dhe shërbimi shëndetësor

Nga data 1 prill 2014, furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar. Ministri i Financave përcakton me udhëzim, para datës 1.4.2014, mënyrën se si veprohet lidhur me sasinë e barnave që rezultojnë gjendje në datën 1.4.2014.".

Neni 4

Në nenin 26/1, "Furnizimet e përjashtuara në import", bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "ç" fjalët "lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure" zëvendësohen me fjalët "që lidhen me realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure".

2. Në fund të paragrafit të parë të shkronjës "ç" shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit.".

3. Në shkronjën "i", fjalët "subjektet e tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël" zëvendësohen me fjalët "tatimpaguesi subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël".

Neni 5

Nga data 1 prill 2014, në nenin 30, "Shkalla tatimore", pika 2 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 50, “Rimbursimet”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalia e parë e pikës 3 riformulohet si më poshtë:

“Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar, i paguar, u rimbursohet financuesve të huaj nga sistemi i thesarit, brenda 30 ditëve, sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Financave.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Duke filluar nga data 1 janar 2014, brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës së tatimpaguesit, drejtoria rajonale e tatimeve kontrollon dhe miraton tepricën kreditore të tatimpaguesit si të rimbursueshme. Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet nga sistemi i thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 7

Në nenin 58, “Biznesi i vogël etj.”, në titull dhe në përmbajtje, fjalët “biznesi i vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimpaguesi subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014. Përjashtimisht, nenet 3 dhe 5 hyjnë në fuqi në datën 1 prill 2014.

Miratuar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8449, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.